

Kushtet e Veçanta për Sigurimin Shtesë nga Aksidentet Personale - DL041008

Neni 1

Dispozitat e Përgjithshme

1. Kushtet e Përgjithshme për Sigurimin e Jetës, në vazhdim Kushtet e Përgjithshme, dhe këto Kushte të Veçanta për Sigurimin Shtesë nga Aksidentet Personale, në vazhdim Kushtet e Veçanta, janë pjesë përbërëse e kontratës për sigurimin e jetës të cilën Kontraktuesi i Sigurimit e nënshkruan me Siguruesin.

Neni 2

Rasti i Siguruar

1. Sipas këtyre Kushteve të Veçanta, varësisht prej zgjedhjes së Kontraktuesit, kontraktohet sigurimi shtesë në rast të:
 - a. Vdekjes si pasojë e aksidentit
 - b. Invaliditetit të plotë ose të pjesshëm, si pasojë e aksidentit
 - c. Shpenzimeve Mjekësore, si pasojë e aksidentit
 - d. Paaftësisë së përkohshme për punë, si pasojë e aksidentit
2. Sipas këtyre Kushteve të Veçanta, aksident do të konsiderohet çdo ngjarje që ndodh për shkak rastësor, të dhunshëm dhe të jashtëm i cili shkakton dëmtime fizike objektivisht të vërtetueshme, si pasojë e të cilave mund të vijë vdekja, paaftësia e përhershme ose e përkohshme për punë. Aksident do të konsiderohet edhe: helmimi gjakut nga thithja apo gëlltitja e substancave, mbytja, ngrirja, goditja e diellit, dëmtimet e shkaktuara nga sforcimet fizike, me përjashtim të: hernies dhe infarkt, asfiksion me origjinë jo patologjike, dëmtimet e pësuar në gjendje sëmundje të mëhershme (para-ekzistuese) ose humbjes së vetëdijes dhe hyrja e trupave të infektuar nëpërmjet plagëve të shkaktuara nga aksidenti.
3. Nëse kontraktohet vetëm rasti i siguruar, cekur në paragrafin b. të pikës 1., të këtij neni, atëherë primi rritet për 30 %.
4. Rastet e siguruar, të cekura në paragrafët c. dhe d., të pikës 1., të këtij neni, nuk mund të kontraktohen, pa kontraktimin e rasteve të siguruar, të cekura në paragrafët a. dhe b., të pikës 1., të këtij neni.

Neni 3

Përjashtimet e Përgjithshme

1. Sigurimi i kontraktuar me këto Kushte të Veçanta, nuk ofron mbulesë për:
 - a. Sëmundjet të cilat vijnë si pasojë e ndryshimeve de-gjenerative (fiziologjike) të organizmit të personit
 - b. Vetëdëmtimet (vetëlëndimet) me pasojë të ndryshme të cilat ndodhin në shenjë të shprehjes së revoltës së pakontrolluar, ose të anti-disponimit (grevat e urisë, tentimet për vetëvrasje, etj.)
 - c. Rastet të cilat mund të parashikohen me metoda mjekësore ose metoda të tjera shkencore
 - d. Rastet kur nuk ekziston lidhja shkakësore midis veprimit të jashtëm dhe pasojave të shkaktuara në trupin e të siguruarit
 - e. Të gjitha sëmundjet përfshirë ato infektive, virusin HIV dhe AIDS, si dhe ndërhyrjet kirurgjikale që nuk kanë lidhje me aksidentin
 - f. Aksidentet që vijnë për shkak të dehjes nga alkooli, përdorimit të tepruar të psiko-farmaceutikeve, përdorimit të drogave të ndryshme, si dhe përfshirjes së personit të siguruar në veprë penale për të cilën është fajtor
 - g. Katastrofat natyrore si tërmeti, përmytjet, zhvendosja e tokës, shpërthimet vullkanike, shpërthimi dhe rrezatimi nga energjia nukleare
 - h. Ngjarjet e luftës, kryengritjet, rebelimet, revolucionet, çrregullimet e rendit publik
 - i. Rastet e shkaktuara ose kontribuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga ana e Personit të Siguruar duke qenë në gjendje çmendurie (të përkohshme ose të përhershme)
 - j. Rastet kur lëndimet nuk janë të shkaktuara gjatë kryerjes së veprimtarisë profesionale të siguruarit, ose gjatë udhëtimit, prej dhe deri, në vendin e punës me transportin e siguruar ose menaxhuar nga Personi i Siguruar

Neni 4

Obligimet e Siguruesit

1. Me kusht që është paguar primi përkatës, Siguruesi, në rast se vërtetohet rasti i siguruar, i paguan Përfituesit:
 - a. Shumën e siguruar, të kontraktuar për vdekje si pasojë e aksidentit
 - b. Shumën e siguruar, të kontraktuar për invaliditetin të plotë, si pasojë e aksidentit
 - i. Për invaliditet total të pjesshëm, si pasojë e aksidentit, Përfituesit i paguhet shuma e siguruar bazuar në përqindjet e paraqitura në tabelën në vijim (për personat që janë majtak, vlerat e anës së djathtë të tabelës së mëposhtme vlejnë për anën e majtë trupore të tyre respektivisht ato të majta për anën e djathtë):

Përshkrimi	Shkalla e Invaliditetit	
	Djathtë	Majtë
një gjymtyrë të sipërm	70%	60%
një dorë ose parakrah	60%	50%
një gisht të madh	18%	16%
një gisht tregues	14%	12%
një gisht të mesëm	8%	6%
një gisht tjetër	8%	6%
një gisht të vogël të dorës apo të këmbës	12%	10%
një falangë të gishtit të madh	9%	8%
një falangë të gishtit tjetër	1/3 e gishtit	
një gisht të madh të këmbës	5%	
një gisht tjetër të këmbës	3%	
një këmbë mbi gju	60%	
një këmbë në apo nën gju	50%	
një këmbë	40%	
dy këmbët	100%	
shikimin në dy sytë	100%	
shikimin në një sy	30%	
dëgjimin në dy veshët	60%	
dëgjimin në një vesh	15%	
humbjen e zërit	30%	
ngushtimin hundor të njëanshëm	5%	
vertebrat kurrizore	7%	
E 12-ta kurrizore	10%	
5 kryqet	10%	

- c. Shpenzimet mjekësore, si pasojë e aksidentit, deri në shumën e siguruar të kontraktuar
- d. Shumën e kontraktuar për çdo ditë të paafëtisë së përkohshme për punë. Ky kompensim paguhet deri në 200 ditë në vit.

Neni 5

Shumat e Siguruar

1. Shumat e siguruara për çdo rast të siguruar përcaktohen në kontratën për sigurimin e jetës. Shuma e paguar brenda një viti, mund të jetë deri 100% të shumës së siguruar, dhe jo më shumë se 150% të asaj shume për kohëzgjatjen e kontraktuar të sigurimit.
2. Nëse ndodh rasti i siguruar dhe Përfituesit i paguhet një shumë e caktuar, sigurimi mbetet në fuqi deri në skadimin e kohëzgjatjes së kontraktuar të sigurimit, për shumat e siguruara të mbetura.

Neni 6

Ndryshimi i Veprimtarisë Profesionale

1. Personi i Siguruar ose Kontraktuesi i Sigurimit duhet të njoftojnë me shkrim menjëherë Siguruesin në rast se Personi i Siguruar ndryshon veprimtarinë profesionale. Në rast se rasti i siguruar ndodh gjatë ushtrimit të një veprimtarie me kategori rreziku më të lartë se ajo e siguruar, Siguruesi do të zbres shumën e siguruar, konform nivelit të rrezikut që paraqet ajo veprimtari

Neni 7

Anulimi i Sigurimit

1. Palët kanë të drejtë të anulojnë sigurimin duke respektuar afatin paralajmërues. Mund të anulohet vetëm sigurimi shtesë nga aksidentet personale, individualisht e të tjerat të mbesin në fuqi, ndërsa në rast të anulimit të sigurimit të jetës atëherë automatikisht anulohet edhe sigurimi shtesë nga aksidentet personale.

Neni 8

Ndodhja e Rastit të Siguruar

1. Personi i Siguruar, Kontraktuesi i Sigurimit ose Përfituesi duhet të njoftojnë me shkrim Siguruesin, sa më parë që është e mundur por jo më vonë se 14 ditë nga ndodhja e rastit të fatkeqësisë, duke treguar vendin, ditën, orën, shkakun dhe pasojat e aksidentit, si dhe të bashkëngjitet një certifikatë të lëshuar nga mjeku që trajton të dëmtuarin. Personi i Siguruar duhet të bëjë çdo përpjekje për minimizimin e pasojave dhe të ndjekë këshillat e mjekut. Personi i Siguruar, dhe në rast vdekje Përfituesi, detyrohen të lejojnë Siguruesin të kryejë verifikimet dhe ekspertimet e nevojshme lidhur me rastin e sigurimit.

Neni 9

Dëmshtëpërblimi

1. Për realizimin e shumës së siguruar, Personi i Siguruar (Përfituesi) duhet ti dorëzojë Siguruesit një kërkesë me shkrim së cilës i bashkëngjiten dokumentet që përcakton Siguruesi. Këto dokumente plotësohen me shpenzimet e kërkuar. Siguruesi paguan shumën e siguruar brenda 10 ditëve nga dita e kompletimit të praktikës së dëmit. Llogaritja e dëmit bëhet sipas kritereve të rregullores së dorëzuar dhe miratuar në BQK.

Neni 10

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1. Mosmarrëveshjet midis palëve, të pazgjidhura me mirëkuptim, zgjidhen në Gjykatën Komunale të paditësit.

Neni 11

Zbatimi i Kushteve të Përgjithshme për Sigurimin e Jetës

1. Në kontratat për sigurim të nënshkruara me këto Kushte të Veçanta zbatohen nenet e Kushteve të Përgjithshme për Sigurimin e Jetës.
2. Nëse ka ndonjë mospërputhje në mes të ndonjëres nga dispozitat e Kushteve të Përgjithshme për Sigurimin e Jetës dhe ndonjëres nga dispozitat e këtyre Kushteve të Veçanta, në marrëdhëniet nga kontrata për sigurim do të zbatohen dispozitat nga këto Kushte të Veçanta.